Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

05/Nr. 965/2026

RAPORTI PËR PROPOZIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PWR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SW SUBVENCIONEVE

Propozimi për plotësim ndryshimin e kësaj rregullore është bërë nga z.Resul Suma -anëtarë i grupit parlamentarë të PDK-së . Me kërkesë e tij është proceduar rregullorja për plotësim ndryshim. Ashtu siç e parasheh Legjislacioni në fuqi, është organizuar debat publik me datën 21.10.2026 dhe prezent kanë qenë 16 (gjashtëmbëdhjet) qytetarë. Edhe në debat publik kanë qenë të njëjtat propozime siç ishin në mbledhje të kuvendit të komunës gjatë shqyrtimit.

Neni 7.3. Mbikëqyrja nga Kuvendi :

1. Kuvendi mund të themeloj komitet për mbikëqyrjen e subvencioneve dhe Bursave si komitet tjetër sektorial, sipas nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit Administrativ MAPL nr.05/2020. Komiteti ka tre anëtarë të Kuvendit dhe dy ekspert jashtë Kuvendit, të propozuar nga administrata komunale dhe të emëruar nga Kuvendi. Emërtimet respektojnë përfaqësimin politik e gjinorë papajtueshmëritë ligjore.

2. Komiteti shqyrton zbatimin e kësaj rregulloreje , transparencën, trajtimin e barabartë dhe përdorimin e mjeteve. Ai i paraqet Kuvendit raporte e rekomandime. Përbërja nominale, mandati, organizimi dhe detyrat e hollësishme caktohen me vendimin e Kuvendit për themelimin e tij.

3. Kryetari siguron raportimet nga drejtoritë kompetente brenda 15 ditëve pas çdo tre mujori dhe brenda 30 ditëve pas përfundimit të secilit cikël të përzgjedhjes . kërkesat shtesë të komitetit marrin përgjigje brenda 15 ditëve të punës, pa cenuar afatet ligjore. Kufizimi i qasjes arsyetohet me bazë ligjore.

4. Anëtari nuk shqyrton dhe nuk voton gjetje për veprimet që i ka përgatitur, vlerësuar , miratuar ose zbatuar vetë. Konflikti i interesit , përjashtimi dhe mbrojtja e të dhënave trajtohen sipas ligjeve përkatëse.

5. Komiteti nuk vlerëson , pikëzon apo rendit aplikime ; nuk përzgjedhë përfitues, nuk vendos për ankesa dhe nuk urdhëron pagesa. Raporti i tij nuk kushtëzon vlefshmërinë ose realizimin e vendimeve individuale. Kompetencat e organeve të përcaktuara në nenet 7-10 dhe në legjislacionin e posaçëm mbeten te ato organe.

6. Kryetari i përgjigjet Kuvendit me shkrim brenda 30 ditëve nga pranimi i rekomandimeve, duke përcaktuar masat, përgjegjësit dhe afatet ose arsyet ligjore për mospranimin e tyre. Komiteti ndjek zbatimin dhe raporton në Kuvend.

7. Për financimin e OJQ-ve , ky nen zbatohet duke respektuar Rregulloren MF nr.04/2017 dhe nuk zëvendëson organet apo procedurat që ajo parashikon.

Dispozitë përfundimtare e aktit të plotësimndryshimit: Akti dërgohet për shqyrtim të ligjshmërisë brenda shtatë ditëve nga miratimi. Publikimi dhe hyrja në fuqi realizohen sipas nenit 27 të rregullores komunale duke respektuar Ligjin nr.08/L-284 dhe Rregulloren QRK nr.03/2026.

Neni 14.2. Kategoritë dhe shumat e subvencioneve për bursa do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës, për çdo vit fiskal si dhe shumat tjera ipen me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës, për të gjitha subvencionet që janë të parashikuara në këtë rregullore.

Plotësim ndryshimi i kësaj rregullore është miratuar në kuvendin e komunës me datë 30.09.2026.

Hani i Elezi
Data: 19.10.2026

Drejtori për Arsim
Hisni Luri